

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6556  
E premte, 11 mars 2022  
çmimi 0.40 €

Sivjet pritet të ratifikohet marrëveshja për transferimin e të burgosurve nga Danimarka | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

VAZHDON RITJJA E ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE BAZË NË KOSOVË | FAQE 4-5

## "FLUTUROJNË" ÇMIMET NË KOSOVË, RËNDOHET JETA E QYTETARËVE



Buka, vaji, mielli, derivatet e naftës, biletat e autobusëve dhe taksitë janë vetëm disa prodhime dhe shërbime të cilat, në dy ditët e fundit, janë shtrenjtuar sërish në tregun e Kosovës. Nga prodhimet ushqimore, një litër vaj, nga më pak se 2.29 euro, është bërë të enjten 3.49 euro. Ky çmim i vajt ka ngjallur reagime të shumta nga shoqëria civile dhe partitë opozitare, duke bërë thirrje që urgjentisht qeveria të reagojë për uljen e çmimeve

### OPINION

KOSOVA SI SHTET AKSIDENTAL DHE EKSPERIMENTAL | F. 8

Milazim KRASNIQI



### AKTUALE



BISLIMI NGA STRASBURGU BËN THIRRJE PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE | F. 7

OSMANI I KËRKON AMBASADORIT AMERIKAN MBËSHTETJEN E SHBA-së | F. 3

### EKONOMI



NUK KALON PROPOZIMI PËR RITJE TË PAGËS MINIMALE NË KOSOVË | F. 3

### SPORT



ALABA ME FESTIM TË RRALLË: MOS U UL NË KARRIGEN TONË | F. 10

Dialogu Kosovë - Serbi, nevojitet përkushtim për arritjen e një marrëveshjeje finale | FAQE 3



UKRAINË - RUSI, PA MARRËVESHJE PËR KORRIDORE HUMANITARE DHE ARMËPUSHIM | FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Ukrainë - Rusi, pa marrëveshje për korridore humanitare dhe armëpushim



**KIEV, 10 MARS** - Takimi ndërmjet ministrit të Jashtëm të Rusisë, Sergei Lavrov, dhe homologut të tij ukrainas, Dmytro Kuleba, në Ankara të Turqisë, ka përfunduar pa një marrëveshje për korridore humanitare si dhe armëpushim. Ministri i Jashtëm i Ukrainës, Dmytro Kuleba, në një konferencë për medie, pas takimit, kë bëre me dije se ka kërkuar hapjen e një korridorit humanitar përmes të cilit do të largoheshin civilët nga qyteti i Mariupolit por, sipas tij, "fatkeqësisht, ministri Lavrov nuk ishte në pozitë që të zotohej për këtë".

Kuleba ka thënë se u kërkua një armëpushim 24 orësh me qëllim "të zgjidhjes së çështjeve më urgjente humanitare". Ministri ukrainas ka bërë me dije se nuk është arritur ndonjë përparim për këtë çështje pasi, siç ka thënë ai, "duket se ka vendimmarrës të tjerë për këtë çështje në Rusi". Mes të tjerash, Kuleba ka thënë se ata ranë dakord t'i vazhdojnë përpjekjet për të kërkuar një zgjidhje për çështjet humanitare dhe ka shtuar se ai është i gatshëm të takohet përsëri në këtë format nëse ka gatishmëri për diskutim thelbësor dhe kërkim

të zgjidhjeve. "Dua ta përsëris se Ukraina nuk do që të dorëzohet dhe nuk do të dorëzohet", ka theksuar ai.

Ndërsa ministri i Jashtëm rus, Lavrov, pas takimit, pati kritika të shumta për Perëndimin, duke thënë se po vepron në mënyrë të rrezikshme me vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë si dhe me rastin e armatosjes së Ukrainës.

Lavrov, mes të tjerash, i akuzoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës për, siç tha ai, përdorimin e territorit të Ukrainës, për të zhvilluar patogjenë që mund të përdoren për të krijuar armë biologjike, një pretendim ky që ShBA-ja e ka quajtur të "çmendur".

Lavrov ka thënë se nuk beson se përplasja e Rusisë me Perëndimin për Ukrainën do të çonte në luftë bërthamore. "Unë nuk dua të besoj dhe nuk besoj se një luftë bërthamore mund të fillojë", ka pohuar ai. Ministri i Jashtëm rus tha se Rusia shpreh gatishmëri për t'i vazhduar diskutimet me Ukrainën. "Takimi i sotëm konfirmon se formati i takimeve Rusi - Ukrainë në Bjellorusi nuk ka alternativë tjetër", ka deklaruar Lavrov.

Takimi që filloi mëngjesin e së enjtes është ndërmjetësuar nga ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Cavusoglu.

Që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës, më 24 shkurt, ky është takimi i parë i ministrit të Punëve të Jashtme të Rusisë, Sergei Lavrov, dhe homologut të tij ukrainas, Dmytro Kuleba. Takimi pason një ditë të gjatë të luftimeve në Ukrainë, ku si pasojë e bombardimit të një materniteti dhe klinike të fëmijëve, u vranë tre persona, ndërsa u plagosën 17 të tjerë.

Autoritetet e Mariupolit njoftuan se në mesin e viktimave ishte një fëmijë. Pavarësisht prej thirrjes së Kulebas për një "korridor humanitar", këshilli i qytetit të Mariupolit raportoi për bombardime ruse edhe më 10 mars. "Bombat po godasin shtëpitë", ka njoftuar këshilli i qytetit në një postim në internet. Ai ka thënë se 1 200 banorë të Mariupolit janë vrarë gjatë rrethimit rus.

Kryqi i Kuq ka thënë se Mariupoli, ku më shumë se 400 000 njerëz janë të bllokuar pa ndihmën humanitare dhe korridore të evakuimit, po përballet me kushte

"apokaliptike".

Këshilltari presidencial ukrainas, Oleksiy Arestovych, akuzoi Rusinë për pengimin e qëllimshëm të evakuimit të civilëve nga Mariupol.

Kremlini ka njoftuar se do ta shqyrtonte sulmin ndaj spitalit në Mariupol, por Lavrov pretendoi se objekti mjekësor në portin strategjik të Detit të Zi kishte shërbyer si një bazë ushtarake për "nacionalistët", një kontradiktë e qartë me deklaratën e zëdhënësit të Kremlinit, Dmitry Peskov, disa orë më parë, se "ne nuk kemi informacion të qartë se çfarë ka ndodhur atje".

Sulmi në spitalin e Mariupolit nuk ishte i vetmi që kishte cak një institucion shëndetësor; në Zhitomir, një qytet me 260 000 banorë, rreth 150 kilometra në perëndim të Kievit, bomba ranë në dy spitale - njëri prej tyre spital për fëmijë, ka shkruar kryebashkiaku Serhii Sukhomlyn në "Facebook". Ai ka pohuar se nuk ka të lënduar. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) ka njoftuar se ka dokumentuar 18 sulme në objektet mjekësore që nga fillimi i pushtimit të

provokuar të Ukrainës më 24 shkurt.

Dhjetëra mijëra civilë ukrainas po përpiqen dëshpërimisht të largohen nga zonat nën bombardimet ruse, që nuk duket se po zvogëlohen me gjithë diplomacinë intensive dhe sanksioneve perëndimore kundër Moskës.

Civilët rifilluan largimin nga qyteti i rrethuar ukrainas Sumi për të tretën ditë përmes një "korridorit humanitar" më 10 mars, pas një marrëveshjeje për një armëpushim lokal, tha guvernatori rajonal.

Disa mijëra njerëz janë larguar nga Sumi këtë javë në bazë të marrëveshjeve të mëhershme me Rusinë, e cila pushtoi Ukrainën më 24 shkurt. Njerëzit po largohen gjithashtu nga vendbanimet e afërta të Krasnopillias dhe Trostianetsit, ka thënë guvernatori Dmytro Zhyvytski.

Rusia e filloi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Që nga ajo kohë kanë humbur jetën qindra njerëz. Pavarësisht prej sanksioneve ndaj Rusisë, kjo e fundit nuk është duke u zbrapsur dhe po vazhdon aksionin ushtarak brenda territorit të Ukrainës.

## Nuk kalon propozimi për rritjen e pagës minimale në Kosovë

PRISHTINË, 10 MARS - Ka dështuar të miratohet propozimi për pagë minimale në vlerë prej 264 eurosh në muaj, ka njoftuar ministri i Financave në Kosovë, Hekuran Murati. Ai ka shkruar në "Facebook" se Këshilli Ekonomik Social ka propozuar pagë minimale prej 240 eurosh në muaj, ndërsa qeveria ka propozuar 1.5 euro për orë, apo 264 euro në muaj. Ministri Murati ka thënë se

nuk është mbështetur nga përfaqësuesit e sindikatave. "Kundërshtimi nga ana e sindikatave nuk ka kuptim dhe nuk mund të shpjegohet meqenëse asnjë nga punëtorët që ata përfaqësojnë nuk preket nga paga minimale, për shkak se pagat e tyre janë dukshëm mbi nivelin e pagës minimale. Krejt çka arrihet me këtë mosvotim është se punëtorët e sektorit privat do të vazhdojnë ta kenë pagën minimale 170 euro", ka

thënë Murati.

Me Ligjin e Punës në Kosovë, ky Këshill propozon vlerën e pagës minimale në fund të çdo viti kalendarik, çka më pas kalon për miratim te qeveria. Kryeministri Albin Kurti katër muaj më parë ka premtuar rritjen e pagës minimale në 250 euro. Vlera e pagës minimale në Kosovë nuk ka ndryshuar nga viti 2011.

Vlera e pagës minimale në Kosovë, sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave,



Eurostat, është më e ulëta në Evropë. Ajo është e ndarë në dy kategori: 130 euro për të

punësuarit e moshës nën 35 vjeç dhe 170 euro për të punësuarit mbi 35 vjeç.

## Dialogu Kosovë - Serbi, nevojitet përkushtim për arritjen e një marrëveshjeje finale

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 MARS - Platforma e Shoqërisë Civile për Dialogun po vazhdon ta përcjellë nga afër procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke rikujtuar që kanë kaluar 11 vjet që nga fillimi i këtij procesi më 8 dhe 9 mars të vitit 2011.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 9 shtator 2010, miratoi rezolutën e cila i hapi rrugë fillimit të dialogut Kosovë - Serbi, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, me mandat të promovimit të bashkëpunimit, përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe përparimit të vendeve në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian.

Që nga fillimi i dialogut para 11 vjetëve deri më tani janë arritur mbi 35 marrëveshje për tema të ndryshme. "Pas kaq viteve nuk është arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish e obligueshme, ashtu siç kërkohet dhe është kushtëzuar përfundimi i këtij dialogu nga Bashkimi Evropian. Nuk ka dyshim se arritja e kësaj marrëveshjeje pikë së pari varet nga vullneti politik dhe përkushtimi i të dyja vendeve, si dhe nga angazhimi dhe koordinimi në mes të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës", është thënë në komunikatën për medie të Platformës së Shoqërisë Civile për Dialogun.

Më tej është theksuar se dialogu mbetet alternativa e vetme për zgjidhjen e kontesteve mes dy



vendeve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe integrimin e tyre evropian. "Palët është e domosdoshme që sa më shpejt t'i kthehen tavolinës së bisedimeve me vullnet të plotë politik për ta

arritur marrëveshjen në fjalë, ndikimi i së cilës nuk do të kufizohej vetëm në normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, por do të kishte efekt stabilizues dhe rritje të sigurisë në Ballkan, sidomos në

rrethanat aktuale pas agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës", thuhet në këtë komunikatë.

Në fund, Platforma e Shoqërisë Civile për Dialogun ka nënvizuar se elemente të rëndësishme që kanë ndikim madhor në suksesin

e këtij procesi negociator mbasin konsensusi i brendshëm politik e shoqëror si dhe transparenca dhe llogaridhënia politike, të cilat nuk janë adresuar si duhet nga qeveritë e Kosovës që nga fillimi i dialogut 11 vjet më parë.

## Osmani i kërkon ambasadorit amerikan mbështetjen e ShBA-së

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim të rregullt ambasadorin amerikan Jeffrey Hovenier.

Në takim është diskutuar për zhvillimet në vend, rajon dhe më gjerë nga ndikimet në ekonomi dhe në fushën e

sigurisë nga lufta në Ukrainë. Presidentja Osmani kërko mbështetjen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për adresimin e pasojave ekonomike nga ngritja e çmimeve të prodhimeve ushqimore bazë në Kosovë. Ajo, gjithashtu, ka potencuar se mbështetja e Shteteve të

Bashkuara është qenësore për thellimin e raporteve dhe bashkëpunimit me NATO-n duke marrë parasysh synimin legjitim të Republikës së Kosovës për të qenë pjesë e Aleancës veritlantike, programit të Partneritetit për Paqe dhe Kartës së Adriatikut.





VAZHDON RITJA E ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE BAZË NË KOSOVË

# “Fluturojnë” çmimet në Kosovë, rëndohet jeta e qytetarëve

Buka, vaji, mielli, derivatet e naftës, biletat e autobusëve dhe taksitë janë vetëm disa prodhime dhe shërbime të cilat, në dy ditët e fundit, janë shtrenjtuar sërish në tregun e Kosovës. Nga prodhimet ushqimore, një litër vaj, nga më pak se 2.29 euro, është bërë të enjten 3.49 euro. Ky çmim i vajit ka ngjallur reagime të shumta nga shoqëria civile dhe partitë opozitare, duke bërë thirrje që urgjentisht qeveria të reagojë për uljen e çmimeve

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 10 MARS** - Kosova është duke u ballafaquar me krizë ekonomike. Rritja e çmimeve, fillimisht e energjisë, së fundmi e naftës dhe, pothuajse, e të gjitha prodhimeve esenciale, ka vështirësuar situatën socio-ekonomike të qytetarëve. Madje, në disa raste, çmimet janë rritur përtej ndikimit real që kriza ekonomike ka pasur në prodhime të caktuara, duke shkaktuar panik te qytetarët. Buka, vaji, mielli, derivatet e naftës, biletat e autobusëve dhe taksitë janë vetëm disa prodhime dhe shërbime të cilat, nga e mërkura e 9 marsit, janë shtrenjtuar sërish në

tregun e Kosovës.

Një litër naftë ka arritur në 1.75 euro, ndërsa një litër benzinë 1.66 euro.

Nga prodhimet ushqimore, një litër vaj, nga më pak se 2.29 euro, është bërë të enjten 3.49 euro; një bukë nga 0.40 euro është bërë 0.50 euro, një kilogram miell ka arritur 0.99 euro dhe një kilogram sheqer 0.99 euro.

Qytetarët thonë se rritja e çmimeve në tregun e Kosovës e ka përkeqësuar gjendjen e tyre sociale. Për rritjen e çmimit të vajit nga 2.29 në 3.49 euro ka pasur reagime të shumta.

Profesori Vigan Qorrolli ka thënë se është koha për spekulantët e tregut dhe përfituesit e tragjedisë

njerëzore. Ai ka bërë thirrje që urgjentisht të ndërhyjë shteti. “Litri i vajit ushqimor në nga 0.80 euro në 3.49 euro. Shteti duhet të ndërhyjë urgjentisht sepse kjo s’ka lidhje me asnjë princip të ekonomisë së lirë të tregut, ku ai është spektator. Ky është një nekrofil tyxharësh ‘par excellence’”, ka shkruar Qorrolli në llogarinë e vet në “Facebook”.

Edhe analisti Imer Mushkolaj ka reaguar pas rritjes së çmimeve të prodhimeve bazë në Kosovë. Ai ka shkruar në llogarinë e vet në “Facebook” se secili tregtar që abuzon me çmimet brenda ‘natës’ duhet të inspektohet nga shteti. “Tregtarë abuzues. A ka inspektorë, a ka shtet që i nalë këta mashtrues,

që brenda natës rritin çmime 100 për qind?”, ka shkruar Mushkolaj.

**Kurti: Çmimet e fryra duhet të shfryhen**

Çmimi i vajit ushqimor në tregun e Kosovës është më i shtrenjti në gjithë botën, ka thënë të enjten kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Ai ka treguar se çmimet e fryra duhet të shfryhen. Kurti ka bërë me dije se inspektorët janë duke e dokumentuar rritjen e këtyre çmimeve. “3.49 euro është (çmim) artificial dhe i paarsyeshëm dhe ka të bëjë me njerëzit që dëshirojnë të përfitojnë. Padyshim se do të marrim masa. Inspektorët janë

duke bërë dokumentimin”, ka thënë Kurti pas vizitës që i ka bërë kompanisë së vajit “Floil”.

Rritjen e çmimit të vajit Kurti e ka cilësuar artificial dhe të paarsyeshëm. “Kjo ka të bëjë me njerëzit që dëshirojnë të përfitojnë nga një krizë botërore dhe jo nga gjendja reale në vendin tonë”, ka thënë ai.

Kurti ka deklaruar se nuk ka nevojë për panik, pasi vaj ushqimor për qytetarët e Kosovës ka edhe për një muaj. “Në stoqet e kësaj fabrike ka edhe rreth 300 mijë litra vaj të papërpunuar, pas përpunimit do të mjaftojnë për një muaj konsum në Kosovë”, ka deklaruar Kurti. Ai ka thënë se qeveria do të angazhohet për bashkëpunim me shtete partnere që ta sjellin lëndën e parë për ripërpunim të vajit.

**Uran Ismaili: Qeveria, spektatore ndaj krizës së çmimeve**

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Uran Ismaili, në një konferencë për medie e ka kritikuar ashpër Qeverinë e Kosovës për mosveprim dhe vonesë në reagim ndaj krizës që ka kapluar qytetarët



## Haradinaj: A je në tokë të bukës, o Albin Kurti?

Për rritjen e çmimeve të prodhimeve ushqimore ka reaguar edhe ish-kryeministri Ramush Haradinaj. Ai ka kërkuar nga Albin Kurti të reagojë në lidhje me këtë situatë ose të lëshojë rrugë. "Vepra ose lësho rrugë, Albin Kurti! A je në tokë të bukës, o Albin Kurti? Kush është ka ta saboton shtetin?! A po sheh se matrapazët po ta godasin popullin. Një litër vaj brenda

natës po të shtrenjtohet gati dyfish!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Haradinaj e ka pyetur Kurtin nëse edhe ai është pjesë e këtij skenari. "A je edhe ti pjesë e këtij skenari, apo je shndërruar në 'komisar për moral'?! Zgjohe, o kryeministër, e kryeje detyrën që ta ka dhënë populli, ose lësho rrugë. A po sheh se është ka soset durimi?!", ka shkruar Haradinaj.

nga rritja e çmimeve.

Ismaili ka thënë se pushteti aktual është treguar shpërfillës ndaj dy krizave të njëpasnjëshme, asaj të energjisë dhe rritjes së papërbalueshme së çmimeve, duke injoruar paralajmërimet nga opozita, shoqëria civile dhe analizat ndërkombëtare. "Kujtojmë se kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, e paralajmëroi qeverinë Kurti për çmimet e energjisë disa muaj para se ato të bëheshin realitet për qytetarin. E njëjta ndodhi edhe kur paralajmëroi që çmimi i produkteve ushqimore do të rritej në masë drastike", ka thënë ai. Sipas Ismailit, qeveria Kurti, fatkeqësisht, ka marrë rolin e spektatores, duke u shndërruar në vëzhguese, jo në aktore. "E për më keq, të vetmen konstante e ka arsytimin. Kjo qeveri krizën energjetike e reduktoi në kërkesën që qytetarët të mos luajnë 'play station', arsytimin që rryma nuk ruhet në frigorifer dhe tani rekomandimin që qytetarët ta kthejnë miellin në furrë. Kështu nuk menaxhohet oferta dhe kërkesa në ekonomi", ka deklaruar Ismaili.

Ai ka thënë se për herë të parë në historinë e pasluftës, qeveria Kurti do ta fusë Kosovën në recension ekonomik. "Në Kosovë sot kemi ngritje marramendëse të çmimeve. Vaji, buka, mielli etj. po tregtohen me çmime që nuk

përputhen me mundësitë financiare të qytetarit të Kosovës. Pushteti aktual është duke soditur këtë krizë nga ndërtesa qeveritare, përderisa qeveritë në rajon dhe Evropë janë duke u marrë aktivisht me krijimin dhe implementimin e politikave, ligjeve dhe veprimeve të ndryshme për t'i mbrojtur qytetarët nga rritja e çmimeve. Në Maqedoni të Veriut, Kroaci e më gjerë kemi veprime konkrete që frenojnë rritjen e çmimeve dhe mbrojnë ekonominë familjare", ka theksuar Ismaili.

PDK-ja konsideron se kriza ekonomike dhe sociale, por edhe pasiguria që po e përjeton qytetari i Kosovës, është mbi betejën ditore partiake e politike dhe propozon që Qeveria e Kosovës të ndërmarrë këta hapa për zbutjen e krizës që i ka kapluar qytetarët tanë: 1. Ta largoj përkohësisht akcizën e aplikueshme mbi importin e naftës për një periudhë tremujore; 2. Largimin e TVSh-së për mallrat esenciale si mielli, vaji, kripa dhe sheqeri deri më 1 korrik; 3. Largimin e TVSh-së për të gjitha lëndët e para në sektorin e bujqësisë deri më 1 tetor; 4. Largimin e TVSh-së për lëndët e para për prodhuesit vendorë të mallrave esenciale deri më 1 shtator; 5. Lansimin e një programi tremujor me BQK-në



deri më 1 qershor për qytetarët që nuk mund ta përballojnë rritjen e çmimeve; 6. T'i mbështesë furnitorët e grurit dhe produkteve të tjera esenciale për t'u qasur në tregjet ndërkombëtare; 7. Të obligohen të gjitha ambasadat e Kosovës të vendosin kontakte për të siguruar furnizim me lëndë të parë për prodhuesit vendorë dhe mallra esenciale për qytetarët.

### Abdixhiku: Jemi në krizë të përballueshmërisë!

Për këtë situatë të çmimeve ka reaguar edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku. Ai ka thënë se vendi është në krizë të përballueshmërisë. "Përderisa qeveria jonë kalon edhe një mbledhje si vëzhguese e krizave ekonomike që kanë tronditur vendin tonë e një botë të tërë, shtetet e rajonit po marrin vendime që me javë të tëra i kemi rekomanduar në Kosovë. Maqedonia e Veriut pak orë më parë uli TVSh-në në naftë e në derivate nga 18 për qind, në 10 për qind. Uli dhe akcizën për to. Nuk u ndal me kaq. Reduktoj në 0 për

### KDI-ja: Kuvendi të mos qëndrojë spektator përballë vështirësive socio-ekonomike të qytetarëve

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka reaguar në lidhje me rritjen e çmimeve, duke theksuar se Kuvendi duhet të qëndrojë spektator përballë vështirësive socio-ekonomike të qytetarëve. "Në një situatë të tillë, përkundër disa propozimeve që janë bërë publike nga aktorë të ndryshëm, përfshirë partitë opozitare, në Kuvendin e Kosovës ende nuk ka pasur debat në nivel politikash, as iniciativa konkrete ligjore lidhur me këtë çështje. Kuvendi i Kosovës, në këtë periudhë krize

për vendin, do të duhej të luante një rol proaktiv për përmbushjen e obligimeve kushtetuese që ka, duke shtyrë përpara politika që përmirësojnë gjendjen ekonomike të qytetarëve pas rritjes enorme të çmimeve", ka reaguar KDI-ja. KDI-ja i ka bërë thirrje Kuvendit të Kosovës që sa më parë të mblidhet për të ofruar zgjidhje konkrete për t'i adresuar nevojat e qytetarëve dhe për të kontribuar për përmirësimin e situatës aktuale socio-ekonomike.

qind të gjitha tatimet - e brendshme e doganore pa dallim - në të gjitha produktet bazike ushqimore. E bëri me qëllim që përballja e qytetarëve atje të jetë sa më e lehtë. Hapa të tillë po marrin shtetet një nga një, por shteti ynë, megjithatë, vështron. Kryeministër, vepra! Jemi në krizë të përballueshmërisë!", ka shkruar Abdixhiku në llogarinë e vet në

"Facebook".

Ai ka thënë se këto janë masa të logjishme, të përkohshme dhe pa ndonjë rezik buxhetor. "Nuk ka rëndësi nga kush vijën e kush i propozon. Rëndësi kanë të implementohen ato. Çdo ditë vonesë e qeverisë suaj me mosreagim është çmim ekonomik i pakthyesëm për gjithë vendin tonë", ka thënë Abdixhiku.



## Një i vdekur dhe 37 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, prej 1 057 testimave, 37 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar edhe një rast i vdekjes. Të enjten janë shëruar edhe

55 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 222 831. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 812. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 314 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 816 842 doza të vaksinës. Deri më sot 817 873 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 98 414 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



## Kryetari i Gjilanit: Themelimi i Universitetit Publik "Kadri Zeka" ishte i domosdoshëm

GJILAN, 10 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka marrë pjesë në ceremoninë e organizuar me rastin e shënimit të nëntëvjetorit të themelimit të Universitetit Publik "Kadri

Zeka". Me këtë rast, kryetari Hyseni ka thënë se Gjilani e kishte themelimin e një universiteti këtu nevojë të pashmangshme dhe të domosdoshme. "Si sot, nëntë vjet më parë, u themelua

Universiteti i Gjilanit 'Kadri Zeka'. Gjilani, si një nga qytetet kryesore të Republikës, si qyteti kryesor i anamoravës dhe në vijë kufitare me Luginën e Preshevës, e kishte themelimin e një universiteti

këtu nevojë të pashmangshme dhe të domosdoshme", ka thënë Hyseni, duke shtuar se është i domosdoshëm bashkëpunimi me të gjitha institucionet. "Synimi është që jo vetëm në Universitetit

'Kadri Zeka', po në të gjitha institucionet arsimore të dalin kadro sa më aktive dhe intelektuale për të mirën e komunitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit", ka thënë Hyseni.



## Premtohet mbështetje për bletarët mitrovicas



MITROVICË, 10 MARS (ER) - Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunën e Mitrovicës, Ferdi Kadriu, së bashku me zyrtarët komunalë të kësaj drejtorie, të enjten kanë mbajtur një takim me bletarët e Mitrovicës.

Në këtë takim morën pjesë edhe kryetari i Shoqatës së Bletarëve të Mitrovicës, Sabri Haziri, si dhe kryetarja e Forumit të Gruas Bletare, Maliqe Mustafa.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi rreth nevojave dhe sfidat që i hasin bletarët mitrovicas, si dhe gjetja e

mundësive për ta përkrahur këtë sektor mjaft të rëndësishëm dhe fitimprurës i blegtorisë.

Gjatë këtij takimi është theksuar trajnimi profesional i bletarëve mitrovicas.

Drejtor Kadriu është zotuar që bletarët do të jenë prioritet në këtë qeverisje, duke u premtuar atyre se do të angazhohet edhe për realizimin e trajnimeve të tilla.

Ndërkaq bletarët mitrovicas u shprehën të jenë shumë falënderues për mundësinë e dhënë për t'i shpalosur brengat, nevojat dhe shqetësimet e tyre.

## Kryetari Latifi vazhdon takimet me qytetarët

RAHOVEC, 10 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar edhe nga nënkryetari Fatmir Iska, edhe këtë të enjte i ka takuar qytetarët të cilët kanë caktuar termin për takim. "Takimet me qytetarët e Rahovecit janë gjithmonë në

funksion të përmbushjes së qëllimeve, planeve dhe projekteve, të cilat e përmirësojnë cilësinë dhe mirëqenien e përgjithshme të jetës së tyre. Edhe kjo e enjte e takimeve me qytetarë ishte shumë produktive. Falënderoj të gjithë ata që sot

ishin në zyrën time dhe paraqitën këshillat, kërkesat, si dhe vërejtjet që kishin rreth punës sonë", ka thënë kryetari Latifi.

Pritja e qytetarëve apo takimet e drejtpërdrejta me qytetarë mbahen çdo të enjte me fillim nga ora 13:00.



# Sveçla takon Escobarin, diskutojnë për luftimin e krimit dhe korrupsionit

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Në kuadër të vizitave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, u prit nga zëvendësndihmëssekretari i Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatike dhe përfaqësuesi special për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

Gjatë këtij takimi ministri Sveçla ka falënderuar Escobarin për rolin e tij në procese të rëndësishme për vendin tonë dhe për ndihmën bujare që i ka dhënë shtetit të Kosovës ndër vite. Ai, gjithashtu, ka theksuar nevojën për të forcuar më tej aleancën me ShBA-në në fushat me interes të përbashkët.

Gjatë këtij takimi u bisedua edhe për arritjet konkrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme në fushën e luftimit të krimit, korrupsionit dhe terrorizmit dhe nevojën e bashkëpunimit të ngushtë për stabilitet afatgjatë në rajon dhe më gjerë.

Gjithashtu, gjatë këtij takimi u diskutua edhe për konfliktin ndërmjet Ukrainës dhe Rusisë dhe qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës ndaj të drejtave të popullit ukrainas si dhe gatishmërinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të qenë një partner i besueshëm në sigurimin e paqes dhe stabilitetit.

Në anën tjetër, Escobari ka shprehur mirënjohjen e thellë

për qëndrimin e Kosovës në mbështetje të Ukrainës dhe ka garantuar përkushtimin e tij dhe të Qeverisë së ShBA-së për ta mbështetur plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Ai, po ashtu, ka falënderuar Kosovën për mbështetjen e saj në strehimin e përkohshëm të qytetarëve afganë si dhe gatishmërinë e treguar nga Qeveria e Kosovës për pranimin e refugjatëve nga Ukraina.

Në fund të takimit të dy u morën vesh ta shtojnë edhe më tej bashkëpunimin në mes të dy vendeve drejt sundimit të ligjit në Kosovë, stabilitetit në rajon dhe unitetit për një përfundim paqësor të konfliktit në Ukrainë.



## Bislimi nga Strasburgu bën thirrje për liberalizimin e vizave

EPOKA  
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 MARS - Zëvendëskryeministri për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, mori pjesë në mbledhjen e KPSA (Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociimin), të zhvilluar në Strasburg. Në fjalën e tij, zëvendëskryeministri Bislimi ka theksuar qëndrimin e Kosovës ndaj konfliktit në Ukrainë, duke u bashkuar me sanksionet e aplikuara nga Bashkimi Evropian kundrejt Rusisë.

Ai ka folur edhe për rezolutën e miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e cila dënon agresionin e Rusisë në



Ukrainë. U shpreh se "BE-ja është përgjigjur në mënyrë të unifikuar e Kosova i është

bashkuar frontit demokratik". Sa i përket aplikimit për anëtarësim në BE,

zëvendëskryeministri Bislimi ka thënë se rezoluta e Parlamentit Evropian që u bënë thirrje institucioneve të BE-së për t'i dhënë Ukrainës statusin e vendit kandidat në BE është shumë inkurajuese edhe për ne. Në këtë drejtim ai ka ritheksuar përparimin e Kosovës në kuadër të agjendës evropiane ERA II si dhe përparimin e shfaqur nga Kosova në fusha si sundimi i ligjit, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe zhvillimit ekonomik si dhe nevojën e përpjekimit të procedurave për anëtarësimin në BE. Kjo, sipas Bislimit, edhe për shkak të situatës gjeopolitike në Evropë dhe parandalimin e influencës ruse në Ballkan. Ai u shpreh se është faktor

shqetësues fakti se Serbia ka dështuar t'i harmonizojë politikat e saj të jashtme me BE-në për vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë.

Zëvendëskryeministri Bislimi bëri gjithashtu thirrje për liberalizimin e vizave për Kosovën. Në fjalën e tij ritheksoi se Kuvendi ka votuar dy herë pro procesit të liberalizimit të vizave në Kosovë, por qytetarët e vendit mbeten ende të izoluar, ndaj është e nevojshme përmbyllja e këtij procesi. Në mbyllje ai potencoi se objektivi kryesor gjeopolitik dhe strategjik i Kosovës është anëtarësimi i ardhshëm në BE, ndërsa dy synime të tjera përfshijnë heqjen e vizave dhe anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

## Sivjet pritet të ratifikohet marrëveshja për transferimin e të burgosurve nga Danimarka

EPOKA  
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 MARS - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pritur të enjten në takim homologun e saj danez Nick Hækkerup. Ajo i ka shprehur mirënjohje për bashkëpunimin korrekt të Mbretërisë së Danimarkës, duke e cilësuar si aleate të vlefshme, veçmas për gatishmërinë e tyre për ta ndihmuar Kosovën në fushën e drejtësisë penale. Palët kanë konfirmuar përparimin në negociatat për arritjen e marrëveshjes përfundimtare për transferimin e të dënuarve nga Danimarka në Kosovë e cila pritet të nënshkruhet dhe të ratifikohet në Kuvend gjatë këtij viti.

Partneriteti i tillë, në mes të Kosovës dhe Danimarkës, ishte pjesë e këtij diskutimi, me ç'rast nga të dyja anët u shpreh vullnet për të bashkëpunuar për interesat e qytetarëve të të dy palëve, për zhvillimin dhe avancimin edhe për interesa të tjera vitale. Partneriteti i fuqishëm në sektorin e drejtësisë, investimet e rëndësishme në fushën e energjisë, janë garanci për zgjerim të bashkëpunimit edhe në fushat e tjera.

Me ministrin e Drejtësisë të Mbretërisë së Danimarkës, Nick Hækkerup, është takuar edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca. Në takim, përveç situatës së sigurisë në rajon pas agresionit rus në Ukrainë, u diskutua edhe për thellimin e bashkëpunimit dhe partneritetit

në fusha me interes të përbashkët në mes të Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës. Me theks të veçantë u nënvizua nevoja e miratimit në Kuvend të marrëveshjes ndërkombëtare dypalëshe për dhënien në shfrytëzim të qelive për të burgosurit nga Mbretëria e Danimarkës, marrëveshje kjo e cilësuar si një gurthemel për bashkëpunimet e radhës.

Konjufca, me këtë rast, ka shprehur mirënjohje për mbështetjen që Mbretëria e Danimarkës ka dhënë për çlirimin, zhvillimin, shtetndërtimin dhe procesin e integritetit evropian të Kosovës. Ai ka theksuar se Republika e Kosovës dhe Mbretëria e Danimarkës kanë ndërtuar marrëdhënie shumë të mira



partneriteti dhe shprehu besimin se mbështetja e shtetit danez ndaj vendit tonë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij, ministri Hækkerup ka konfirmuar përkushtimin e

Mbretërisë së Danimarkës për përkrahjen e Republikës së Kosovës në fusha të ndryshme zhvillimore, si dhe në rrugën evropiane dhe të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

# Kosova si shtet aksidental dhe eksperimental

Trazirat e marsit 2004, minimizimi i rolit të NATO-s në çlirimin e Kosovës, pjesëmarrja e frikshme e mercenarëve nga Kosova në luftërat në Siri e në Irak, loja hipokrite me demarkacionin me Malin e Zi, idetë për shkëmbimin e territoreve, lojërat politike për bashkimin me Shqipërinë, tentativat për zhbërjen e Gjykatës Speciale, të gjitha së bashku kanë ndikime hutuese ose irituese tek aleatët e Kosovës, të cilën e kanë ndihmuar pavarësinë e saj, për ta bërë shtet të lirë e demokratik brenda sferës atlantike, e jo epru vetë për eksperimente.



Milazim KRASNIQI

Mund të duket hipotezë paksa e çuditshme, por është afër së vërtetës që Kosova deri vonë nuk ka qenë në ndonjë axhendë relevante, për t'u themeluar si shtet i pavarur e sovran. Historia e saj nga antika e këndej është e mjegulluar nga pushtimet e huaja, nga organizimet e ndryshme administrative, nga kalimi prej një pushtuesi te tjetri. Për më tepër, në kufijtë e sotëm me të cilët u shpall shtet i pavarur më 17 shkurt 2008, nuk ka ekzistuar asnjëherë, deri në vitin 1974, sepse në variacionet e ndryshme, që nga Dardania, Stara Srbija, Vilajeti i Kosovës, ka qenë ose pa kufij të definuar ose me kufij të tjerë.

## Kosova për serbët nuk është "objekt i racionales dhe të logjikshmes"

Përderi sa gjeografia ka luajtur me kufijtë e Kosovës, historia është vënë në lojë prej saj. Nga ajo mori ngjarjesh historike që përplasen në tokën e saj, dy ngjarje historike kanë pasur implikime dhe ndikime të mëdha dhe kanë edhe sot: Beteja e Kosovës e vitit 1389 dhe Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit në vitin 1878. Mbi të parën është krijuar miti serb për Kosovën si "tokë e shenjtë serbe" ose "Jerusalem serb", i cili qëndron në themel të pretendimeve serbe madje edhe të gjenocidit serb kundër shqiptarëve në këtë hapësirë gjeografike. Por edhe pas gjenocidit të fundit të viteve 1998-1999, asgjë nuk ka ndryshuar në përjetimin mitik e iracional të Kosovës nga serbët, gjë që sublimohet në fjalët e patriarkut serb, Porfirije: "Kosova për ne është e farkuar me qiellin dhe në atë kuptim nuk mund të jetë objekt i pragmaticitetit, objekt i racionales dhe të logjikshmes". Kur një gjë nuk mund të jetë objekt i racionales dhe të logjikshmes, është objekt i iracionales dhe të jologjikshmes, gjë që farktohet edhe në këtë mendim të njeriut

të parë të Kishës Ortodokse Serbe, i cili poashtu pohon se: "Ajo që është Vatikani për Kishën Katoliko-Romane, është Kosova për ne." Kësaj, Kosova në sytë e serbëve rezultojnë të jetë kategori mentale iracionale dhe kategori historike spekulative. Mbi këtë përjetim ka ndodhë edhe fjalimi i Millosheviqit në Gazimestan më 28 qershor 1989, mbi këtë përjetim ka ndodhë gjenocidi në vitet 1998-1999, mbi këtë përjetim Serbia refuzon ta njohë ekzistencën e Kosovës si shtet. Ndërsa mbi ngjarjen e dytë, atë të vitit 1878, është konstituuar miti i formimit të kombit shqiptar. Miti shqiptar për Lidhjen e Prizrenit është racional dhe si i tillë nuk paraqet rrezik për ekzistencën e shtetit serb e astë serbëve në Kosovën e pavarur. Megjithatë, këtu nuk do të diskutohet më tutje as vërtetësia e ngjarjeve, as moraliteti i miteve, po vetëm dimensionin gjeopolitik që kanë nxitur e nxisin edhe sot në Kosovë përplasjet ndërmjet serbëve e shqiptarëve, po edhe të Fuqive të Mëdha. Dimensionin gjeopolitik i kësaj hapësire shqiptare, që në atë kohë ishte nën sundimin osman, u shfaq pas Kongresit të Berlinit. Ndonëse territori i Kosovës së sotme nuk u prek me ato vendime, me faktin që Kosova u shndërrua në periferi të territorit ku jetonin me shumicë shqiptarët, u shndërrua në problem, sepse periferia zakonisht shndërrohet në problem të sigurisë. Megjithatë, Kosova nuk mbeti gjatë periferi e Shtetit Osman, sepse u pushtua në vitin 1912 nga Serbia e nga Mali i Zi, që e copëtuan, duke e shpërbërë jo vetëm periferinë shqiptare po edhe kompaktësinë demografike, fetare e kulturore. Sikundër dihet, Mali i Zi e filloi edhe një proces shtesë dekompozimi të Kosovës, me anën e konvertimit të dhunshëm të muslimanëve shqiptarë në ortodoks. Në rastin e mbetjes së Kosovës nën Serbi, nuk ndikoi vetëm fakti që ajo u pushtua në rrëmujën e Luftës së Parë Ballkanike. Në fakt, mbetja e saj nën Serbi u arsytua pikërisht me mitin e Betejës së Kosovës, por pas asaj fasade ideologjike ishte projekti gjeopolitik rus për dominim në Ballkan. Interesi i proklamuar serb si i motivuar nga historia e nga miti, u

shfrytëzua nga Rusia për ta forcuar pretendimin e vet pansllavist-imperialist. Edhe pas Luftës së Parë Botërore, u mirëkuptua pretendimi serb dhe Kosova vazhdoi të mbetej nën tutelën serbe e pansllave. Prej saj doli vetëm në vitet 1941-1945, në rrëmujën e Luftës së Dytë Botërore, por u rikthyeshërisht nën sundimin jugosllav, i cili nga viti 1945 ishte regjim komunist. Pra, që nga dalja nga ombrella osmane, Kosova ishte në sferën ruse të ndikimit, ideologjikisht nën sundimin e iracionales dhe të palogjikshmes.

## Në aspektin gjeopolitik ekzistenca e Kosovës ende është pezull

Lëvizjet shqiptare të refuzimit e të rezistencës gjatë tërë asaj periudhe prej vitit 1912 e këndej nuk aspironin krijimin e një shteti të pavarur me emrin Kosovë. Lëvizjet e vetëmbrojtjes dhe rezistencës ishin iredentiste, pra, me aspiratën që Kosova të shkëputjen nga shteti serb-jugosllav e të bashkohej me Shqipërinë. Por fuqia e atyre lëvizjeve ishte e pamjaftueshme për ta ndryshuar pozitën gjeopolitike të Jugosllavisë, për ta nxjerrë nga sfera ruse në atë të Perëndimit. Kjo edhe për faktin se faktorët ndërkombëtarë, në kuadrin Luftës së Ftohtë, nuk provokonin ndryshime që do të kishin reperkusione serioze në ato hapësira. E mbanin situatën të temnsionuar, por jo shpërthyes. Pse? Sepse me marrëveshjen e Ruzveltit, Çerçillit e Stalinit në Jaltë, ishte vendosur që edhe Jugosllavia e edhe Shqipëria të mbeteshin në bllokun komunist, ku edhe nëse kishte fërkime etnike, ato do të trajtoheshin "brenda familjes komuniste". Natyrisht që ka pasur tentativa nga SHBA e Perëndimi që të ndikohet për destabilizimin e regjimeve totalitare, veçmas atij në Shqipëri, por për për shkak tëkomplotëve të tipit të Kim Fillbit brenda shërbimeve, ato projekte nuk kanë pasur sukses. Letargjia gjeopolitike do të vazhdonte shumë gjatë, po të mos shpërthente kriza e brendshme në ish federatën e Jugosllavisë, pas vdekjes në Titos në vitin 1980. Pas vdekjes së Titos, turbulencat po kërkonin përgjigje në dimensionin etnik e gjeopolitik të krizës, ku SHBA dhe NATO tashmë e kishin sfiduar shumë më ashpër Bashkimin Sovjetik dhe Traktatin e Varshavës. Me demonstratat e marsit-prillit 1981 dhe veçmas me brutalitetin që përdori shteti jugosllav ndaj protestuesve paqesorë, Kosova u shndërrua në njërin nga gurët e parë të dominos që filloi ta rrokulliste atë krizë. Europës së ripërtëritur, pas katastrofës në Luftë e Dytë Botërore, filloi t'i fanitej si në një ëndërr fakti që

kishte një pjesë të veten nën regjime gjakatare komuniste, të cilën duhej ta rikthente në gjirin e vet. Si fillim sytë u hodhën te kombet katolike, polakët, sillovenët dhe kroatët. Kosova mund të jetë imponuar edhe pa dashjen e tyre dhe pa gatishmërinë e saj, por u imponua shkaku i brutalitetit serb kundër shqiptarëve. E meqë Kosova ishte bërë me Kushtetutën e vitit 1974 edhe njësi federale dhe kishte kufijtë e vet, (ndonëse formalisht ishte edhe pjesë e Serbisë, si krahinë autonome socialiste) ajo fitoi një peshë konkrete edhe si problem gjeopolitik. Kosova mund të përdorej si katalizator për krizën jugosllave, po edhe për ndryshimet që mund të provokoheshin në Shqipërinë e izoluar e të harruar. Mirëpo, Kosova paraqiste rrezik për stabilitetin e brishtë të Maqedonisë, ku interesat amerikane ishin më të theksuara. Pra, Kosova ishte një lloj bombe. Sidoqoftë, deri në bombardimet e NATO-s, përkatësisht deri në termat e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake të Kumanovës, Kosova trajtohej si pjesë e Jugosllavisë nga të gjithë, pra edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra, në asnjë rast nuk u trajtua si segment i çështjes shqiptare në Ballkan sikundër kemi qejf ne ta paraqesim me ngjyrat e ndezura të pseudonacionalizmit. Kjo gjë është shumë me rëndësi të kuptohet, sepse nëse kuptohet drejt, na ndihmon ta kuptojmë faktin themelor se Kosova shtet i pavarur është bërë shtet në mënyrë aksidentale, në pamundësi që të menaxhohej projekti nazist serb për Serbinë e Madhe, që tentoi të realizohej me anën e spastrimit etnik dhe të gjenocidit. Po të pranonte Millosheviqi Marrëveshjen e Rambujesë, Kosova do të mbetej në kornizën e shtetit të cunguar jugosllav, natyrisht me një autonomi substanciale, siç e pati emërtuar presidenti francez Shak Shirak, në hapje të asaj konference. "Korniza e këtyre bisedimeve është përkufizuar shumë qartë nga Grupi i Kontaktit. Ju do të keni këtu parimet e një autonomie thelbësore". (Bodin:158) Pra, maspranimi i marrëveshjes nga Serbia dhe bombardimet e NATO-s mbi caqet ushtarake jugosllave e serbe, si përgjigje ndaj atij refuzimi, definitivisht e shndërroi Kosovën në një entitet me rëndësi globale gjeopolitike. Edhe njëri nga pjesëmarrësit në të gjitha përplekjet për frenimin e krizës dhe për gjetjen e paqes në ish Jugosllavi, Xhejms Pardju, konkludon se pavarësia e Kosovës nuk ishte në ato faza në planet e akterëve ndërkombëtar, veçse u torpedua nga politika e Millosheviqit: "Millosheviqi mund t'i ishte shmangur pavarësisë për Kosovën, por e

bëri një gabim strategjik, me peshë kritike, në periudhën ndërmjet tetorit të 1998-s dhe marsit të 1999-s. Po të kishte bashkëpunuar me bashkësinë ndërkombëtare, ta kishte kthyer në normale shkallën e forcave të sigurisë, ta kishte negociuar autonominë për Kosovën dhe t'i lejonte paqeruajtësit ndërkombëtarë ta monitoronin marrëveshjen, ai me siguri se do ta kishte zvarritur pavarësinë e Kosovës dhe mund t'i ishte shmangur pavarësisë si rezultat i pranueshëm për bashkësinë ndërkombëtare. Në vend të kësaj, Millosheviqi zgjodhi konfrontimin, duke e garantuar në të vërtetë më herët pavarësinë". (Pardju: 207)

## Boça e kandarit nuk rri në një pozitë

Pas bombardimeve të NATOs mbi caqet ushtarake në Jugosllavinë e Zhablakut, Kosova definitivisht mori peshë globale gjeopolitike dhe kaloi në sferën atlantike. Por, Kosova e sotme ende mund të llogaritet si shtet eksperimental. Idetë morbide për shkëmbim territorësh, ose edhe për krijimin e një entiteti serb, janë dëshmi se Kosova ende nuk e ka siguruar ekzistencën e vet si shtet i pavarur dhe sovran, ende nuk është partner plotësisht i besueshëm i NATO-s dhe SHBA-së. Pse? Sepse disa veprime në këto vite kanë shkaktar se hutim ose iritim tek aleatët e saj. Fjala vjen, trazirat e vitit 2004, minimizimi i rolit të NATO-s në çlirimin e Kosovës, pjesëmarrja e frikshme e mercenarëve nga Kosova në luftërat në Siri e në Irak, loja me demarkacionin me Malin e Zi, idetë për shkëmbimin e territoreve, lojërat politike për bashkimin me Shqipërinë, tentativat për zhbërjen e Gjykatës Speciale, të gjitha këto kanë ndikime hutuese ose irituese tek aleatët e Kosovës, të cilën e kanë ndihmuar pavarësinë e saj, për ta bërë shtet të lirë e demokratik e jo epru vetë për eksperimente. Pra, duhet ta mbajmë mend: në vorbullin e krizës jugosllave të viteve '90, Kosova e pavarur për shqiptarët ishte ideal, por shtet u bë nga një zhvillim aksidental, që lidhej me refuzimin serb në Rambuje. Nëse drejtuesit e Kosovës nuk e kuptojnë këtë rrugë të shtetndërtimit drejt dhe këtë pozicion ende të pasigurt vendit të vet, ata mund të dëshojnë në transformimin e tij në një shtet të qëndrueshëm, stabil e të suksesshëm. Shumica prej tyre deri sot kanë qenë e janë larg që ta kuptojnë këtë gjë. Nuk e kuptojnë se boça e kandarit në politikë e edhe në gjeopolitikë nuk rrinë gjithmonë në të njëjtën pozitë. Fjala vjen, po të hiqte dorë Serbia nga përjetimi iracional dhe jologjik i Kosovës e me atë rast të anëtarësohej në NATO, pozita gjeopolitikee Kosovës do të



# Si mund të fitojë Perëndimi kundër Rosisë



**Nga Eliot A. COHEN**  
"The Atlantic"

Në fillim u shfaq tronditja: imazhet e raketave dhe predhave të artilerisë që përplaseshin mbi godinat e banimit, helikopterë në flakë, mijëra refugjatëve që kalonin përtej kufirit, një president i sfilltur dhe i parruar që i lutej për ndihmë udhëheqësve politikë në Perëndim, burra me uniformë që pozonin para tankeve dhe autobindave të djegur, policia ruse që kontrollon celularët e qytetarëve në rrugët e Moskës për biseda disidente.

Shqetësimi dhe zemërimi ishin reagime të natyrshme. Por ka ardhur koha të mendohet në mënyrë strategjike, duke pyetur që i lutej për ndihmë udhëheqësve politikë në Perëndim, burra me uniformë që pozonin para tankeve dhe autobindave të djegur, policia ruse që kontrollon celularët e qytetarëve në rrugët e Moskës për biseda disidente.

Edhe përgjigja në lidhje me luftën në Ukrainë, ashtu si me shumicën e problemeve të tjera strategjike, është më pak e drejtpërdrejtë sesa mund të mendohet. Në nivelin më bazik, një autokrat rus po punon të nënshtrojmë me mjetet më brutale të mundshme një vend të lirë dhe të pavarur, pavarësinë e të cilit ai nuk e ka pranuar asnjëherë.

Por këtu ka çështje edhe më të gjera. Luftërat e tjera të epokës së pasluftës së Ftohtë mund të kuptohen ose interpretohen si pasojë e luftës civile dhe e lëvizjeve separatiste, apo e kundërpërgjigjeve të vogla ndaj agresionit. Por jo sulmi rus në Ukrainë. Ky sulm ishte i paprovokuar, i pakufizuar në objektivat e tij, dhe i pakufizuar në mjetet që po përdor. Prandaj, është

një sulm jo vetëm ndaj atij vendi, por ndaj të gjitha normave ndërkombëtare. Në rrezik është i gjithë rendi botëror. Putin nuk e ka fshehur kundërshtimin e tij të fortë ndaj NATO-s dhe pavarësisë së ish-republikave sovjetike. Dhe duhet pritur që pas Ukrainës, ai do të tentojë diçka të ngjashme (edhe pse me më pak intensitet) në shtetet baltike.

Ai e ka rikthyer luftën në formën e saj më të ashpër në një kontinent, që ka lulëzuar kryesisht në mungesë të tij për gati 3 breza. Dhe lufta e tij përbën një kërcënim edhe për integritetin dhe vetëbesimin e demokracive liberale të botës. Pra ajo çka po luhet është shumë e madhe, dhe bashkë me të edhe rreziqet.

E megjithatë ka një lajm të mirë në solidaritetin dhe vendosmërinë e jashtëzakonshme të demokracive liberale, në Evropë dhe jashtë saj. Roli që po luan Australia dhe Japonia në përgjigjen ndaj pushtimit rus, nuk është më pak i rëndësishëm se ai Britanisë apo Francës. Në këtë aspekt, Ukraina e vitit 2022, nuk është Çekoslovakia e vitit 1938. Jo vetëm sepse po lufton fort kundër pushtuesit, por sepse demokracitë janë me të materialisht dhe moralisht. Po ashtu dallimi këtë herë është se agresori nuk është ekonomia më e përparuar e Evropës, por një nga më të dobëtat.

Ushtria e saj nuk është si Wehrmacht-i tejet efektiv, por një turmë burrash të keq-udhëhequr, gjysmë kompetentë, edhe pse të mirë-armatosur, më të përshtatshme dhe të prirur për të masakruar civilët, sesa për një luftë kundër një ushtrie profesioniste të një vendi perëndimor.

Dështimi i Rosisë për të dominuar

hapësirën ajrore ukrainase, kolonat e saj të blinduara të bllokuara, tanket e saj nën flakë, janë dëshmi e dobësisë së ushtrisë ruse. Në këto kushte, koalicioni i shteteve liberal-demokratike, kryesisht evropiane, i udhëhequr nga SHBA-jaduhet të ketë tre objektiva.

Synimi më i dukshëm i strategjisë perëndimore është çlirimi i Ukrainës, rivendosja e qeverisë dhe institucioneve të saj të lira, rindërtimi i ekonomisë, dhe garantimi i pavarësisë së saj, duke e vendosur atë në një pozicion sigurt, dhe duke qenë e mirë-armatosur kundër një sulmi të ngjashëm në të ardhmen.

Kjo do të përfshijë një ankorim të këtij vendi në Bashkimin Evropian. Tek e fundit, kjo mund të përfshijë edhe hyrjen e saj në NATO, aleancë që ka shpëtuar shumë nga fqinjët e saj nga një fat i ngjashëm. Por që të ndodhë kjo, duhet të ndodhë më parë mposhtja në terren e trupave ruse.

Por objektivat përballë Rosisë, duhet të shkojnë përtej kësaj. Në mënyrë ideale, ky konflikt do të përfundojë me rrëzimin nga pushteti të Vladimir Putin, njeriun që mban përgjegjësi të veçantë për këtë luftë, jo vetëm moralisht, por edhe politikisht. Rënia e tij mund të ndodhë si rezultat i pakënaqësisë së elitës, e cila çon në një grusht shteti, apo nga trazirat popullore masive. Megjithatë, asnjë rezultat nuk mund të parashikohet, dhe për momentin, asnjë nga këta skenarë nuk duket i afërt. Për më tepër, ndonëse disidentët rusë kanë treguar një guxim të jashtëzakonshëm, regjimi po shfrytëzon me mjeshtëri ksenofobinë dhe shovinizmin përmes kontrollit të plotë të mediave ruse.

Në këtë aspekt, Rusia është në shumë aspekte një shtet fashist funksional, duke kontrolluar një ideologji nacionaliste, në shërbim të një lideri të plotfuqishëm. Për këtë arsye, dhe duke përjashtuar një revolucion të ri rus, objektivi i Perëndimit duhet të jetë dobësimi i madh i Rosisë nga kjo luftë, që ajo të jetë e paafte në të ardhmen për të përsëritur një sulm të ngjashëm, e izoluar dhe e përçarë brenda vendit, deri në pikën që një autokrat i plakur të bjerë nga pushteti.

Por nuk mjafton vetëm vënia në shënjestër e Putinit. Kina po e vëzhgon me vëmendje pushtimin e Ukrainës. Po ashtu edhe Irani dhe regjimet më pak autoritare, po vlerësojnë nëse mundësi të tilla janë të disponueshme për ta, apo janë tepër të rrezikshme për t'u ndërmarrë.

Me sukseset që do të arrijnë fuqitë perëndimore, duhet t'i detyrojnë ato të arrijnë në përfundimin, se diçka e tillë bart shumë rreziqe. Në këtë aspekt strategjia perëndimore duhet të mbështetet në 3 shtylla kryesore: mbështetje e fuqishme ushtarake për forcat e rregullta dhe të parregullta ukrainase; për sanksionet që do të dëmtojnë ekonominë ruse; dhe së treti për ndërtimin e një aleance evropiane të fuqishme ushtarakisht, që mund të sigurojë kufirin me Rusinë për sa kohë që ky vend do të vazhdojë të mbetet një kërcënim.

Armatimi i Ukrainës, që tashmë ka filluar, është një detyrim moral. Kur njerëzit janë të gatshëm të luftojnë për lirinë e tyre kundër një armiku, metodat dhe synimet e të cilit janë qartësisht kaq shumë të liga, Perëndimi e ka për detyrë t'i mbështetë. Një imperativ strategjik, që synon të pengojë ushtrinë ruse dhe të dobësojë pozicionin e

Putinit.

Mbështetja për ushtrinë ukrainase, edhe nëse bien qytetet ukrainase, për kryengritjen e vazhdueshme, ka perspektivën të garantojë në fund një sukses të jashtëzakonshëm. Një vend më i madh në madhësi se sa Franca, me shumë zona urbane, me pyje, dhe në perëndim memale, me qindra mijëra burra dhe gra të armatosura, dhe me ndihmën e mijëra luftëtarëve të huaj, është praktikisht i pamposhtur nëse armatimet si duhet.

Këtë e tregon edhe historia e pushtimit sovjetik të Afganistanit në vitet 1980, ku ndihma nga CIA amerikane, bëri që muksahedinët të mposhtnin një superfuqi globale. Carl von Clausewitz thoshte dikur se përdorimi maksimal i forcës, nuk është aspak i papajtueshëm me përdorimin e njëkohshëm të inteligjencës. Kjo vlen për Ukrainën.

Vladimir Putin ka vetëm një avantazh. Si oficer i KGB-së ai ka mësuar të luajë blufën me armiqtë e tij, qofshin këta disidentë apo fuqi të huaja. Frika është arma kryesore e Moskës, dhe udhëheqësit rusë janë të aftë në përdorimin e saj.

Por frika është gjithashtu e ndjeshme ndaj "ilaçit", që po përdoret sot nga ukrainasit dhe nga shumë të tjerë në të kaluarën. Siç tha dikur Churchill, guximi është virtyti që bën të mundur të gjitha virtytet e tjera. Pa guxim, Perëndimi nuk mund të ketë sukses, por me të nuk mund të dështojë.

*Marrë me shkurtime*

**Shënim:** Eliot A. Cohen, është profesor në Shkollën e Studimeve të Avancuara Ndërkombëtare të Universitetit Johns Hopkins, SHBA. Në vitet 2007–2009, ka qenë Këshilltar i Departamentit të Shtetit.

*Bota.al*

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Drita dhe Gjilani ndajnë pikët, Ballkani mbetet në pozitën e parë

Derbi i skuadrave nga regionin e Anamoravës, Dritës dhe Gjilanit, përfundoi me rezultat 1-1. Shkaku i këtij barazimi skuadra e Ballkanit mbetet në pozitën e parë. 3-3 përfundoi ndeshja tjetër e zhvilluar të enjten në mes të Llapit dhe Drenicës



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 10 MARS** - Derbi më i madh në futbollin e Kosovës në mes të Dritës dhe Gjilanit ka përfunduar pa fitues (1-1) dhe ky rezultat i mundëson Ballkanit që të mbetet i pari në renditjen tabelore të BKT Superligës. Dy skuadrat gjilanasë janë në garë për titull dhe mbesin një, përkatësisht gjashtë pikë prapa klubit nga Suhareka. "Festuar ndeshjen, por jo edhe rezultatin. Kemi bërë një ndeshje të madhe sot, duke dominuar kundër kundërshtarit në çdo aspekt. Goli që realizuam erdhi falë gabimit të mbrojtësit tonë. Arritën të na ndëshkonin pas gabimit. Por, djemtë luftuan shumë, treguan karakter", ka thënë trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu.

Ndeshja e zhvilluar në Gjilan ishte mjaft interesante. Të parët në epërsi kaluan futbollistët e Gjilanit në minutën e 20, me golin e Shend Kelmendit. Pjesa e parë përfundoi me rezultat 0-1, por goli i Gjilanit nuk e uli motivin e Dritës për të arritur deri te goli i barazimit, të cilin e shënoi në minutën e 53-të mbrojtësi Ilir Blakçori. Në minutat në vazhdim rastet nuk munguan, por rezultati mbeti i pandryshuar dhe skuadrat i ndan pikët. "Kjo është një ndeshje

derbi. Ka pasur disa gabime për shkak të fushës së rënduar. Rezultati është gjithmonë real, pasi në çastet kur pritej ta godisnim kundërshtarin, e pranuar golin. Nuk guxojmë të pranojmë gola të tillë por, sidoqoftë, jam i kënaqur me angazhimin e futbollistëve të mi në këtë ndeshje. Golin e shënuam më herët sesa që e planifikuam. Nuk u frikësua se mund ta humbim ndeshjen edhe pse Drita pati disa raste të mira, por që erdhën pas pranimit të golit që ndikoi shumë", ka thënë Ismet Munishi, trajner i Gjilanit.

Drita është e treta me 42 pikë, kurse Gjilani pozicionohet në vendin e dytë me 47 pikë. Të enjten është zhvilluar edhe ndeshja tjetër në mes të Llapit dhe Drenicës në stadiumin "Zahir Pajaziti", e cila përfundoi me rezultat 3-3. Vendasve iu deshën vetëm tre minuta për të kaluar në epërsi me golin e Bianor Netos, kurse kuqezinjët barazuan pas shtatë minutave me autogolin e Peposhit. Pjesa e parë përfundoi me këtë rezultat, derisa në minutën e 58 Kreshnik Uka i kaloi në epërsi kuqezinjët nga Skenderaj. Dhjetë minuta më vonë Ilir Krasniqi i barazoi shifrat në 2-2. Uka edhe një herë shënoi për epërsinë e Drenicës (2-3), por Llapi nuk lejoi të mbetet pa pikë nga kjo ndeshje dhe në minutat shtesë barazoi rezultatin në 3-3 me

golin e shënuar nga Alef Firmino. Llapi mbetet në vendin e katërt dhe ka grumbulluar 40 pikë, kurse Drenica është një pozitë më poshtë me 32 pikë. Të mërkurën janë zhvilluar tri ndeshjet e tjera. Malisheva e ndali hovin e Ballkanit duke e mposhtur me rezultat 2-0. Prishtina u është rikthyer fitoreve, duke e mposhtur Feronikelin me rezultat 3-0. Ndeshja në mes të Ulpianës dhe Dukagjinit përfundoi me rezultat të barabartë 1-1.

BKT SUPERLIGA	
Drita - Gjilani	1-1
Llapi - Drenica	3-3
Malisheva - Ballkani	2-0
Ulpiana - Dukagjini	1-1
Feronikeli - Prishtina	0-3
Tabela	
1. Ballkani	48 pikë
2. Gjilani	47
3. Drita	42
4. Llapi	40
5. Drenica	32
6. Prishtina	29
7. Malisheva	29
8. Dukagjini	25
9. Ulpiana	23
10. Feronikeli	11

## SHKURT

### Prishtina paraqet amerikanin Thomas

Klubi i Basketbollit Sigal Prishtina ka paraqitur edhe një basketbollist të enjten. Bëhet fjalë për qendrën amerikane Devin Thomas. 26-vjeçari, i gjatë 206 centimetra, së fundi luajti në Estoni te Kalev/Cramo, ndërsa karrierë ka bërë edhe në Argjentinë, Izrael, Spanjë dhe Turqi. Prishtina të enjten e ka paraqitur edhe fundorin Henry Dugat.

### Ademi priti në takim menaxherin e ngjarjeve në FIFA, Uran Bajramajn

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, të enjten ka pritur në takim Uran Bajramajn, menaxher i ngjarjeve në FIFA, njëherësh shqiptari i vetëm i cili punon në këtë institucion të futbollit në botë. FFK-ja ka njoftuar se Bajramaj u shpreh i lumtur me pamjen e re të selisë së FFK-së dhe për shumë suksese të tjera dhe projekte të reja të cilat pritet të realizohen vitet në vijim me të cilat e ka njoftuar kryetarin Ademi. I pari i FFK-së e ka falënderuar për vizitën dhe e ka përgëzuar për arritjet dhe punën që Bajramaj e bën në FIFA.

### Guardiola: Shorti do të jetë i vështirë

Menaxheri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, është shprehur i lumtur me kualifikimin e skuadrës së tij në 1/8 e finales së Ligës së Kampionëve. "Qytetarët" mbrëmë eliminuan Sportingun e Lisbonës. Strategu spanjoll është i vetëdijshëm se shorti për sfidat e raundit të ardhshëm në Ligën e Kampionëve nuk do të jetë i lehtë. "Jam i lumtur që kemi ardhur deri këtu. Kjo është gjeja më e rëndësishme. Sigurisht se shorti do të jetë i vështirë. Më vjen keq që do të jetë vështirë për ne, por edhe për kundërshtarin tonë", ka thënë Guardiola.

### Pochettino afër shkarkimit, PSG-ja ëndërron 'Zizun'

E ardhmja e Mauricio Pochettinos është e vendosur tashmë. Sipas gazetës "L'Equipe" dhe medieve të tjera franceze, strategu argjentinas do të largohet në fundin e sezonit. Edhe pse kontrata e tij përfundon në vitin 2023, klubi parisien po punon për ta gjetur pasuesin e tij. Ëndrra e madhe është Zinedine Zidane, i cili mund të jetë trajneri i duhur për t'i udhëhequr yjet e PSG-së drejt një triumfi të mundshëm në Ligën e Kampionëve. Pak ditë më parë drejtori sportiv Leonardo mohoi një pajtim të mundshëm me strategun francez edhe pse është përfolur shpesh për të.

## Ukraina i heq Tymoschukut licencën e trajnerit dhe trofetë e fituara

KIEV, 10 MARS - Në Ukrainë ka një "stuh" presioni mbi Anatoliy Tymoschuk, ish-kapitenin e kombëtares, tani zëvendëstrajner i rusëve të Zenit San Petersburgut. Ukrainasit e cilësojnë fajtor sepse nuk ka mbajtur kurrë linjën kundër

pushtimit. Për këtë arsye komiteti i etikës i Federatës së Futbollit të Ukrainës ka propozuar heqjen e licencës së trajnerit, të gjitha çmimeve dhe nderimeve, të gjithë trofeve të fituara si futbollist në Ukrainë dhe përjashtimin nga regjistri

zyrtar i lojtarëve të kombëtares. "Që nga fillimi i agresionit ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës, Tymoschuk jo vetëm që nuk ka bërë asnjë deklaratë publike për këtë temë, por as nuk e ka ndërprerë marrëdhënien e tij të punës me

klubin e agresorit. Ai ka qëndruar i heshtur edhe pas Bayern Munichut, skuadra për të cilën ka luajtur në të kaluarën, e cila ka mbajtur qëndrim. Me këtë zgjedhje të vetëdijshme ai po dëmton futbollin ukrainas", thuhet në njoftimin e Federatës.



## Alaba me festim të rrallë: Mos u ul në karrigen tonë

MADRID, 10 MARS - David Alaba ka hyrë në histori edhe pse nuk ishte brilant në ndeshjen që Real Madridi e fitoi me shifrat 3-1 ndaj PSG-së. Mbappe shpeshherë e kaloi austriakun, ashtu si edhe në rastin e golit që thaujse nxori jashtë loje madrilënët. Por, gjithsesi, ai është kthyer në një nga lojtarët ikonë të kualifikimit për tifozët madrilënë pas kësaj

sfide për një festim të rrallë. Kur Benzema shënoi golin e tretë, lojtari i ekzaltuar mbërtheu një nga karriget e mbikëqyrësve të ulur rreth fushës dhe e ngriti lart mbi kokë si pjesë të festës. Një pamje që ka bërë xhiron e botës duke u shpërndarë me shpejtësi në rrjetet sociale. Edhe vetë Alaba e ka shpërndarë në rrjetet sociale foton e tij me një mesazh të qartë

për të gjithë ata që sfidojnë madrilënët në turneun e tyre, Ligën e Kampionëve. "Mos u ul në karrigen tonë", ka shkruar mbrojtësi austriak, duke shpjeguar domethënien e atij festimi të çuditshëm që pushtoi rrjetin, duke hedhur dorashkën e sfidës për të gjithë ata që do të tentonin ta pengonin Realin në rrugën drejt trofeut të radhës.



## Phoenixi siguron 'play-off'-in, fitojnë Chicago dhe Bucks

MIAMI, 10 MARS - Phoenix mposhti të enjten me rezultat 111-90 Miamin, në duelin mes dy ekipeve që kryesojnë konferencat respektive në NBA dhe siguron matematikisht zonën "play-off". Të gjithë titullarët e Phoenixit realizuan mbi 10 pikë, me Bookerin



protagonist, autor i 23 pikëve. Vijon kriza e lakersave, që sot u mundën me rezultat 139-30 nga Houstoni pas kohës shtesë. LeBron Jamesi realizoi një "triple double", me 23 pikë, 14 rebounde e 2 asistime, por që s'mjaftuan. Për teksanët u dallua Green me

32 pikë. Fiton Chicago, që falë 36 pikëve të DeRozan dhe 25 të LaVine, mundi 114-108 Detroitin jashtë fushës. Kampionët e Milwaukee Bucksit mposhtën 124-115 Atlantën, ndeshje ku dallimin e bëri Antetokounmpo me 43 pikë e 15 rebounde.

### REZULTATET

Charlotte - Boston	101-105
Detroit - Chicago	108-114
Miami - Phoenix	90-111
Houston - Lakers	139-130
Milwaukee - Atlanta	124-115
Minnesota - Oklahoma	132-102
New Orleans - Orlando	102-108
Dallas - New York	77-107
San Antonio - Toronto	104-119
Sacramento - Denver	100-106
Utah Jazz - Portland	123-85
Clippers - Washington	115-109

## Seedorf: Nuk e shoh Mbappen te Reali

Legjenda holandeze Clarence Seedorf ka dyshime në lidhje me kalimin e Kylian Mbappes te Real Madridi nga Paris Saint-Germaini. Seedorf ishte një nga ekspertët që komentoi lojën për Amazon Prime Italia dhe ndau mendimet e tij për

mundësinë e bashkimit të Mbappes me Real Madridin si lojtar i lirë në fund të sezonit. "Unë nuk e shoh Mbappen në këtë ekip (Real Madridin)", ka thënë fillimisht ish-reprezentuesi holandez. "Nëse ai luan në të majtë, do të thotë që

Vinicius Jr duhet të mbetet jashtë. Ku do të luante? Në të djathtë në vend të Asensios? Kjo është një mundësi. Shikoni se çfarë bëri Karim Benzema sonte (mbrëmë). Ai e kuptoi që skuadra kishte nevojë për të, ndaj u fut thellë për të

marrë topin. Mbappe nuk e bën këtë. Neymari e bëri atë në vend të kësaj, duke u përpjekur ta rimarrë kontrollin e lojës. Ndoshta Mbappe ka nevojë për një mjedis tjetër për t'u rritur më tej", ka përfunduar Seedorf.

### SHKURT

#### Qeveria e Britanisë ngrin asetet e Abramovichit, nuk mund ta shesë Chelsean

Qeveria e Britanisë së Madhe ka vendosur ta sanksionojë pronarin e klubit të futbollit të Chelsea, Roman Abramovich. Miliarderi rus është një nga shtatë oligarkët rusë, asetet e të cilëve bllokohen, në vendimin e fundit të Downing Street. Në një dokument të Thesarit Britani, Roman Abramovich përshkruhet si një oligark pro Kremlinit që ka lidhje të ngushta me presidentin rus Vladimir Putin. Pak ditë më parë Abramovich hoqi dorë nga presidenca e Chelseat dhe vendosi ta nxirrte klubin në shitje, në një lëvizje që shumë e konsideruan si një përpjekje për t'i shitur sa më shpejt asetet që ta shmangte bllokimin e tyre nga sanksionet.

#### Djokoviqi tërhiqet edhe nga Indian Wells

Tenisti serb Novak Djokoviq, edhe pse disa ditë më parë ishte hedhur short, nuk do të luajë në turneun Masters të Indian Wellsit, që nisi në Amerikë. Shkak është bërë mosmarrja e vaksinës kundër Covid, masë e detyrueshme për të hyrë në Amerikë. Vendin e Djokoviqit në këtë turne e ka zënë bullgari Grigor Dimitrov. "Edhe pse isha përfshirë në listën e pjesëmarrësve dhe isha në short, e dija që do të ishte e pamundur të udhëtoja për në Amerikë. Rregullat për personat e pavaksinuar nuk kanë ndryshuar, ndaj nuk do të luaj në Indian Wells", u shpreh tenisti serb, që prej dy javësh ka lënë kreun e renditjes botërore dhe ndodhet i dyti.

#### Ancelotti: Jam shumë i lumtur që jemi në çerekfinale

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, është shprehur tejet i lumtur me kualifikimin e ekipit të tij në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Reali e mposhti 3-1 Paris Saint-Germainin në ndeshjen e dytë të 1/8 së finale të Ligës së Kampionëve për të avancuar tutje. Kylian Mbappe e kaloi Parisin në epërsi në pjesën e parë, përpara se Karim Benzema të përgjigjet me "hat-trick" në të dytën dhe ta sigurojë fitoren dhe kualifikimin. "Ne arritëm të fitojmë pas një lojë shumë të vështirë, e cila u komplikua edhe më shumë me golin e Mbappes. Jemi përpjekur të bëjmë presion ashtu siç kemi stërvitur dhe pas golit të parë, në fillim të krijojmë edhe më shumë raste pas përkrahjes së fuqishme të tifozëve. Jam shumë i lumtur që jemi në çerekfinale", ka thënë Ancelotti.

#### Pochettino, pas eliminimit: Do të jetë e vështirë për t'u rikthyer

Trajneri Mauricio Pochettino ka thënë, pas eliminimit nga Liga e Kampionëve, se kjo garë ka qenë synim i PSG-së. Sipas trajnerit argjentinas, rikthimi do të jetë i vështirë. "Loja ndryshoi pas golit të parë të pësuar dhe e vështirë për t'u pranuar. Ne dominuam në gjashtëdhjetë minutat e parë. Kemi bërë gabime pas këtyre minutave, por është shumë e vështirë të menaxhosh një ekip pas një ngjarjeje të tillë. Liga e Kampionëve ishte qëllimi i PSG-së. Do të jetë e vështirë për t'u rikthyer. Ne humbëm nga një prej klubeve më të mira në botë, por tani bëhet e vështirë", ka thënë Pochettino. PSG-ja e fitoi ndeshjen e parë kundër Real Madridit me rezultat 1-0, por e humbi ndeshjen e dytë me rezultat 3-1.

# NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Te Pasulat B.I shpalle te pavlefshme certifikaten e biznesit me nrb: 811758921.
- ▶ Melihate Meha shpalle te pavlefshme diplomen e fakultetit filozofik te universitetit te prishtines - Dega Pedagogji.
- ▶ Adnan Hasani shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore :Enver Hadri".
- ▶ Luan Buqinca B.I shpalle te pavlefshme certifikaten e TVSH-se me nr: 330009698.
- ▶ Emine Haxhiu B.I shpalle te pavlefshme certifikaten me numer fiskal 600632253.
- ▶ Zoja Avdiu shpalle te pavlefshme deftesene shkolles fillore "Musa Hoti" Ish Meto Bajraktari.
- ▶ Pranvera Hajrizi shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore "Musa Hoti".
- ▶ Remzi Hajredini shpalle te pavlefshme diplomen e SHMLT" Arkitekt Sinani".
- ▶ Auto Taxi Sami Leku B.I shpalle te pavlefshme certifikaten e Binesit me Nrb: 80656599.
- ▶ Haxhi Isufi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollë fillore "Ahmet Rrustemi" Bec, Gjakovë.
- ▶ Hatmon Isufi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ahmet Rrustemi", Gjakovë.
- ▶ Fjolla Emra nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së fillore nga klasa e -I- deri në të -VIII-tën, shkolla "Yll Morina" Gjakovë.
- ▶ Zeqir Qunaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Ramadan Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Luigj Gurakuqi" Nashec.
- ▶ Haxhi Mucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Pjeter Budi" Lubizhdë e Hasit.
- ▶ Altin Saramati shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Heronjtë e Lumes" Vermicë.
- ▶ Miran Saramati shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Heronjtë e Lumes" Vermicë.
- ▶ Ilirjan Hamza nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- ▶ Arbnore Hoti Rogovë KK Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Alban Anwar Rogovë KK. Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Agron Bardhi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh, m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, Elektro.
- ▶ Shqipërim Kuka Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë Elektro.
- ▶ Rexhep Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- ▶ Francika Barbullushi Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal in më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

